



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Shqyrtimi i Shtatë (shumë-vjeçar) i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE7)

Raporti i parë Konsultativ

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE për të marrë komente dhe qëndrime nga palët e interesit. Dokumenti nuk përfaqëson vendim të ZRRE-së.

11 qershor 2012




Përmbajtja

1	Hyrje	1
1.1	Qëllimet e Shqyrtimit të tarifës shumë-vjeçare (TSHV)	1
1.2	Përshkrimi i procesit të TSHV-së	1
1.3	Sfondi i strukturës së industrisë	2
1.4	Qëllimi i këtij Konsultimi	2
2	Çështjet kyçe për shqyrtimin e TSHV	4
2.1	Vlerësimi i shpenzimeve të të licencuarve	4
2.2	Shitja e mundshme e bizneseve të licencuara	5
2.3	LOMAG	5
2.4	Gjendja e sistemit dhe përmirësimi i performancës	6
2.5	Humbjet	6
2.6	Mekanizmat e stimulimit në kontrollin të hyrave	6
2.7	Kostoja e marrëveshjes	7
2.8	Konkurrenca në treg	7
2.9	Harmonizimi i kontrollit të të hyrave dhe viteve të kontabilitetit	7
2.10	Faktorët tjerë	8
3	Forma dhe struktura e kontrolleve të të hyrave	8
3.1	Kohëzgjatja e kontrolleve	8
3.2	Natyra e kontrolleve	8
3.3	Veçoritë stimuluese të TSHV	9
4	Vlerësimi i kostove në çdo biznes	9
4.1	Natyra e shpenzimeve të çdo të licencuari	9
4.2	Qasja e propozuar për vlerësimin e shpenzimeve	9
4.3	Faza 1 – Grumbullimi i të dhënave	10
4.4	Faza 2 – Analiza e të dhënave	10
5	Përcaktimi i të hyrave	11
5.1	Modeli i kontrollimit të të hyrave	11



5.2	Trajtimi i humbjeve	12
6	Hapat e ardhshëm	12
6.1	Finalizimi i procesit të shqyrtimit të TSHV	13





1 Hyrje

Në shkresën e datës 8 qershor 2012, ZRRE-ja njoftoi palët e interesit për fillimin e Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike, (SHTE7) i cili, për herë të parë, do t'i mundësojë të licencuarit përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara për periudha shumë vjeçare. Ky raport i parë konsultativ përcakton qëndrimin fillestar të ZRRE-së mbi procesin dhe orarin e tij. Ai gjithashtu iu ofron të licencuarve një mundësi të shqyrtojnë formularët e raportimit të propozuara nga ZRRE-së, të cilat do të përdoren si bazë për mbledhjen e të dhënave për shqyrtim.

1.1 Qëllimet e Shqyrtimit të tarifës shumë-vjeçare (TSHV)

Në konsultimet e saj të vitit 2011 lidhur me ndryshimet e legjislacionit sekondar ZRRE-ja propozoi zhvendosjen në periudha shumë-vjeçare, dhe jo një-vjeçare të kontrollimit. ZRRE-ja beson se ky ndryshim do të sjellë sektorin energjetik të Kosovës më afër praktikave më të mira ndërkombëtare dhe se të licencuarit do të përfitojnë nga një siguri më e madhe mbi rrjedhat e të hyrave të tyre të ardhshme. Në një industri me vlerë të madhe të asetëve, siç është industria e energjisë elektrike, planet investive duhet të jenë të koordinuara ngushtë me të hyrat dhe ZRRE-ja beson se qasja shumë-vjeçare do të lejojë një shqyrtim më të afërt të lidhjes midis investimeve dhe cilësisë së shërbimit.

1.2 Përshkrimi i procesit të TSHV-së

ZRRE-ja ka vendosur të nisë procesin e TSHV-së në maj të vitit 2012, rreth nëntë muaj para përcaktimit të tarifave rezultuese. Orari i paraparë në letrën e ZRRE-së të 8 qershorit 2012 gjithashtu parasheh tre raste të konsultimeve publike, si dhe mundësi të mjaftueshme për takime për sqarim me të licencuarit. Kjo do të përmirësojë transparencën e përgjithshme të procesit, dhe të mundësojë që të hyrat të përcaktohen mbi një bazë të fortë. Procesi është si në vijim:

- Inicimi i konsultimeve mbi formatin e raportimit shumë-vjeçar – 11 qershor 2012
- Data përmbyllëse për konsultime – 29 qershor 2012
- Formatet për raportim iu dërgohen të licencuarve – 9 korrik 2012
- Afati i fundit për të kthyer formatet, të përcjellura me parashtrimet e shkruara – 31 gusht 2012
- Dëgjimi publik në të cilin të licencuarit i paraqesin parashtrimet e veta ZRRE-së dhe publikut – 3 shtator 2012
- Vlerësimi kalimtar i publikuar për konsultim – 19 tetor 2012
- Data e fundit për konsultim – 9 nëntor 2012
- Vlerësimi përfundimtar i publikuar për konsultim – 28 dhjetor 2012
- Data e fundit për konsultim – 18 janar 2013
- Dëgjimi publik – 11 shkurt 2013
- Vendimi përfundimtar mbi Të Hyrat Maksimale të Lejuara – 28 shkurt 2013
- Të licencuarit propozojnë tarifën dhe ngarkesat e tyre rezultuese për aprovim – 15 mars 2013
- Aprovimi i tarifave dhe ngarkesave – 29 mars 2013

Comment [f1]: Mekanizmat shumë-vjeçarë tarifor mund të punojnë në ekonominë me përkrahje me sisteme elektrike të qëndrueshme dhe struktura të kostos. Kosova është larg të qenit e qëndrueshme dhe me siguri nuk mund të udhëhiqet në mënyrë automatike që ky proces implikon.

Comment [f2]: Te licencuarit kanë siguri minimale mbi rrjedhat e tyre të të ardhurave duke pasur parasysh që ZRRE-ja do të përpunojë të gjitha të dhënat në një model që ende nuk është ndërtuar

Comment [f3]: Kjo është sigurisht e rëndësishme, megjithatë, duke pasur parasysh se Kosova do të jetë në mungesë të kapaciteteve deri në fund të kësaj dekade, duhet të kihet kujdes në përcaktimin e standardeve të performancës.

Formatted: Highlight

Comment [f4]: Komentet e përgjithshme në lidhje me procesin: Kjo është një bashkim i tarifave i fokusuar vetëm në "Menaxhim" të tarifës përfundimtar të shitjes me pakicë. Në mjedisin e tregut të shthurur, të licencuarit individual duhet si të pavarur të propozojnë nivelet e tyre të kostos dhe çmimin për shqyrtim dhe miratim nga ZRRE-ja.

Comment [f5]: Ekzistojnë 47 fletë pune Excel për KEK-un për të shqyrtuar. Disa paraqesin Llogaritje krijësisht të re të kostos, Matje të Punës, Kontabilitetin e Pronave, Matje të Performancës dhe kërkesat për Statistikat Teknike që aktualisht nuk ekzistojnë dhe në disa raste do të duhen vite për tu zhvilluar. Është kritikë që investitori i KEDS-it të përfshihet menjëherë në këtë proces konsultimi. KEK-u po jep komente brenda afatit të lejuar 18 ditor. Për shqyrtim, është e nevojshme kohë më e gjatë.



Gjatë shqyrtimeve paraprake të tarifave, ZRRE-ja gradualisht ka futur në zbatim formate më specifike të raportimit. Këto tash janë zgjeruar, dhe nevojiten më shumë detaje. Në veçanti, në vitet paraprake janë kërkuar vetëm të dhënat e realizuara nga viti paraprak, si dhe të dhënat e parashikuara për vitin aktual. Në këtë proces shumë-vjeçar, ZRRE-ja kërkon të dhëna historike për pesë 5 vite historike, një vlerësim të gjendjes së të dhënave të përgjithshme për vitin aktual dhe pesë vite parashikim. Formatet e raportimit të dhënave diskutohen më në hollësi më vonë në këtë dokument.

Comment [f6]: Parashikimet janë të mira, megjithatë, në Kosovë ato nuk mund të jenë "te mbyllura", sepse e ardhmja është aq e pasigurt.

Sapo të jenë pranuar formularët e kompletuar nga të licencuarit, të dhënat do të përdoren në një model të të hyrave i cili është duke u ndryshuar dhe rafinuar për qëllime të shqyrtimit aktual, dhe do të azhurnohet krahas rregullave të reja të çmimeve.

Formatted: Highlight

1.3 Sfondi i strukturës së industrisë

Në vitin 2006, aktivitetet e transmisionit të sektorit të energjisë janë ndarë nga KEK-u dhe janë inkorporuar në pronësi shtetërore të sistemit të transmisionit dhe operatorit të tregut, KOSTT-i. Në kohën e shqyrtimit aktual, sektori është duke kaluar nëpër shthurje gjegjësisht ndarje të mëtejme të KEK-ut, ku aktivitetet e shpërndarjes dhe të furnizimit u ofrohen në shitje investitorëve ndërkombëtarë. Ky transaksion i shitjes është në zhvillim e sipër. Projekti i Qeverisë Kosova e Resynon të vendosë termocentralin Kosova B në duart e një investitori privat, i cili gjithashtu do të ngarkohet me ndërtimin e një termocentrali të ri me thëngjill, me fuqi 2 x 300MW. ZRRE-ja beson se blerësit potencialë do të mirëpresin një qasje shumë-vjeçare, gjë që zvogëlon pasigurinë në lidhje me të hyrat e ardhshme, dhe jep më shumë informata mbi shpenzimet e parashikuara në të ardhmen se sa që aktualisht është e mundur në domenin publik. Ky raport konsultativ diskuton implikimet e këtyre reformave në shqyrtimin.

1.4 Qëllimi i këtij Konsultimi

Strategjia energjetike e Kosovës është duke i shtyrë reformat aktuale të sektorit. Edhe pse këto duhet të ofrojnë përfitime konsumatorëve për nga cilësia më e mirë e furnizimit dhe shërbimi i përmirësuar i konsumatorëve, këto përmirësime kanë një kosto, për të cilën të licencuarit duhet të kompensohen përmes tarifave. Shqyrtimi shumëvjeçar do të mundësojë një kontrollim më intensiv të këtyre kostove dhe ZRRE beson se një proces transparent konsultativ do të përmirësojë kuptimin e marrëdhënieve ndërmjet koston së shërbimit dhe cilësisë së shërbimeve. Është me rëndësi që konsumatorët të kuptojnë se pse u kërkohet të paguajnë për furnizimin me rrymë dhe të kuptojnë se për çka përdoren pagesat e tyre.

Ky raport konsultativ në Aneksin I jep propozimet fillestare të ZRRE-së lidhur me shabllonet e raportimit të cilat do të kërkojë të plotësohen nga të licencuarit. Formatet e raportimit do të rishqyrtohen pas kontributit të të licencuarve. Pikësynimi i kyç është të kërkohen këndvështrime lidhur me formën dhe fushëveprimin e kërkesave për të dhëna nga të licencuarit.

Comment [f7]: Informacionet që kërkohen në disa prej formave të të dhënave mbulojnë më shumë se procesin e tarifave. Metoda e propozuar paraqet tërësisht një Kontabiliteti të ri Rregullator, Raportim Rregullativ, dhe koncepte të Matjes së Punës në të cilat KEK-u është i gatshëm për të punuar, megjithatë, kjo do të marrë kohë.

Përveç kësaj, kërkojmë mendime lidhur me orarin e shqyrtimit të përcaktuar me letrën e ZRRE-së të datës 8 qershor 2012.



Në fund, kërkohet mendime lidhur me supozimet e propozuara të ZRRE-së të parapara në këtë raport.

Propozimet e ofruara në këtë raport janë vetëm të natyrës indikative dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohen si vendime të ZRRE-së.

Komentet duhet të dërgohen deri në **29 qershor 2012** në:

Comment [f8]: ZRRE-ja inkurajohet që të marrë të dhëna prej investitorit të ri të KEDS-it. Kjo mund të kërkojë zgjatjen e periudhës së komenteve.

Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave

Ero.pricing-tariffs@ero-ks.org

Rr. Hamdi Mramori Nr. 1

10000 Prishtinë, Kosovë



2 Çështjet kyçe për shqyrtimin e TSHV

Kjo pjesë paraqet disa çështje të cilat ZRRE duhet t'i shtjellojë gjatë shqyrtimit dhe parashtron pyetje për shqyrtim të duhur.

2.1 Vlerësimi i shpenzimeve të të licencuarve

ZRRE-ja ka detyrë statutores të sigurojë që të licencuarit të mbeten në gjendje të mirë financiare dhe të fitojnë një kthim të arsyeshëm të investimeve të tyre. ZRRE-ja nuk mund thjesht të pranojë atë që të licencuarit kërkojnë përkitazi me tarifën, por duhet të bëjë një shqyrtim të hollësishëm të shpenzimeve për t'u siguruar që konsumatorët të mos paguajnë më shumë se që kanë nevojë, dhe se pagesat e tyre japin përfitime maksimale për nga disponueshmëria e përmirësuar dhe cilësia e furnizimit.

Tendencat, niveli dhe natyra e kostove të parashikuara nuk mund të interpretohet drejt, përveq nëse ato kuptohen duke iu referuar kostove historike. Për këtë arsye, ZRRE-ja do t'u kërkojë të licencuarve të përcaktojnë shpenzimet historike operative dhe kapitale. Të licencuarit do të duhet t'i kenë këto të dhëna në dispozicion, edhe pse do të nevojiten disa rregullime për t'u siguruar që kostot historike dhe kostot e parashikuara të jenë mbi bazë të njëjtë.

Për parashikim të shpenzimeve, të licencuarit duhet të bëjnë supozime të caktuara. ZRRE-ja do t'u kërkojë të licencuarve të mendojnë mirë këtë supozim teksa shqyrtojnë kthimin, si dhe t'i cekin qartë supozimet e bëra. Të gjithë të licencuarit, dhe ZRRE-ja, pastaj duhet të pajtohen mbi supozimet e përbashkëta të së ardhmes për të siguruar konsistencë të të gjitha palëve të interesuara.

Aktualisht të dy operatorët në sektor, KEK-u dhe KOSTT-i, mbajnë licenca të shumëta. Do të ketë elemente të ndarjes së kostos ndërmjet aktiviteteve të ndryshme të licencuara. ZRRE-ja do të shqyrtojë bazën e alokimit për t'u siguruar që ajo është e arsyeshme, se nuk ka numërim të dyfishtë, dhe se nuk ka keq-alokim të cilat mund krijojnë shqetësime lidhur me konkurrencë në të ardhmen. ZRRE-ja nuk ka ndërmend të mikro-menaxhojë aktiviteteve afariste të të licencuarve, por është me rëndësi që ZRRE-ja të jetë e kënaqur se kostot që barten nga bizneset janë të arsyeshme në raport me përfitimet e konsumatorët.

Një nga përfitimet kryesore të kontrollit shumë-vjeçar është se u lejon operatorëve kohë të mjaftueshme të reagojnë ndaj nxitjes për të përmirësuar punën dhe produktivitetin. Rregullat e reja të çmimeve paraqesin stimuj të tillë. Në rastin e KEDS-it, disa nga faktorët tashmë janë përcaktuar për vitin 2012 dhe për pesë vitet e kontrollit të ri në Vendimin e Bordit të ZRRE-së të datës 6 shkurt 2012. ZRRE-ja do të ketë nevojë të vendos parametrat për KOSTT-in dhe për të licencuarit e tjerë të KEK-ut si pjesë e këtij shqyrtimi.

Comment [f9]: Fakti është se të licencuarit nuk kanë shumë informacion në dispozicion në sistemin aktual të kontabilitetit dhe raportimit. KEK-u ka filluar përpjekje shtesë për të punuar me ZRRE-në për të siguruar të dhëna kuptimplota.

Comment [f10]: Pikënisje për procesin e tarifave në Kosovë ka qenë gjithmonë "Balanci i Energjisë" (Parashikimi Ngarkesës dhe Orari i Furnizimit) për vitin e ardhshëm. Ky proces, i cili është në përputhje me praktikën e shërbimeve ndërkombëtare, duhet të përfshihet në këtë dokument

Comment [f11]: Këtu në Kosovë nuk ka qenë kurrë një çështje e kalkulimit/logaritjes së dyfishtë ose problem të alokimit të gabueshem

Formatted: Highlight

Formatted: Highlight



2.2 Shitja e mundshme e bizneseve të licencuara

Ndryshimi potencial në pronësi gjatë periudhës së kontrollit (ose edhe gjatë vetë shqyrtimit) nuk paraqet ndryshim të madh. Është struktura e shpenzimeve për kryerjen e aktiviteteve të licencuara e cila është duke u shqyrtuar, dhe për të cilën duhet të përcaktohet pagesa, dhe ato aktivitete të licencuara nuk do të ndryshojnë. ZRRE-ja e kupton se një nga shtytësit kryesorë të Strategjisë energjetike të Qeverisë për transaksion e KEDS-it është që të jep një shtysë shtesë për të arritur përmirësimin e performancës, si në aspektin e zvogëlimit të humbjeve, ashtu edhe në fitimet e përgjithshme të efikasitetit.

Përderisa KEDS-i formalisht nuk ndryshon pronësinë, KEK sh.a. do të vazhdojë të ketë obligimin ligjor për të kryer aktivitetet e licencuara. KEK-u duhet të sigurojë në të dhënat e veta dëshmi të një plani të fortë biznesi për kostot e investimeve, ato operative dhe të mirëmbajtjes për të punuar me afarizmin e distribucionit dhe të furnizimit gjatë pesë viteve të kontrollit të ri. Në rast se biznesi i shitet me sukses një pronari të ri, është e arsyeshme të supozohet se pronari i ri mund të dëshirojë të ndryshojë planet e investimit të biznesit. ZRRE mund të konsiderojë shqyrtimin e planit të ri nëse është e sigurtë se plani i modifikuar i investimeve do të sjellë përfitim më të madh për konsumatorët sa ai fillestar. Përfitimet e konsumatorëve duhet të jenë më të mëdha se kostot shtesë të këtij plani eventual.

Prandaj, një supozim themelor për KEK-un në kompletimin e kthimit të tij është që ai do të vazhdojë të jetë operatori i biznesit të KEDS-it gjatë pesë viteve të periudhës së kontrollit, pasi që ai është i vetmi burim i kostove të parashikuara që është në dispozicion për momentin.

Për transaksionin e gjenerimit, kjo situatë nuk është e prerë aq qartë. ZRRE-ja beson se të licencuarit duhet të supozojnë se transaksioni është duke vazhduar tutje dhe duhet të përdorin gjykimin e tyre më të mirë teknik për të parashikuar kohën më të mundshme të lëshimit në punë. Kjo do t'u mundësonte të licencuarve të nxjerrin shpenzimet e tjera - ato të energjisë së importuar, si dhe kostot e tjera që mund të jenë të domosdoshme për të zvogëluar mungesën e energjisë në vitet e ndërmjetme.

ZRRE kërkon mendimet e palëve të interesit lidhur me këto supozime.

2.3 LOMAG

LOMAG, apo shkurt "Land of Mines and Generation – Toka e minierave dhe e gjenerimit" i referohet një zone në perëndim të qytetit të Prishtinës ku gjenden termocentralet Kosova A dhe B si dhe miniera të hapura të linjtit, së këndejmi edhe emri i tyre. Energjia e furnizuar nga rrjeti i transmisionit në LOMAG shpenzohet nga KEK-u (për konsumin vetanak, gjegjësisht konsumin në miniera, prodhim dhe nën-stacione) si dhe nga konsumatorët tarifor (industrial, komercial dhe shtëpiak).

Shtjellimi i çështjes së LOMAG-ut ka implikime për nivelin e humbjeve të raportuara nga KEK-u dhe mund të ketë implikime për tregun e ardhshëm konkurrues. Gjithashtu KEK- u në aplikacionin e tij

Comment [f12]: Investitori i KEDS mund të mos dëshirojë që KEK-u të përcaktojë parashikimin e saj 5 vjeçar dhe rezultatin e rrjedhës se të ardhurave

Comment [f13]: Investitori i ri mund të ketë nevojë të të jetë i përfshirë në këtë proces meqë KEK-u nuk është në dijeni të planeve të investitorit të ri

Comment [f14]: Kosova e Re nuk do të jete ne funksion në periudhën e parashikuar 5 vjecare (2013-2017).



gjatë SHTE6 ka propozuar që biznesi i PES duhet të vendosë një pagesë interne për biznesin e gjenerimit të KEK-ut. Këto pagesa interne nuk do të kenë ndikim në çmimet e konsumatorëve, por do të lehtësojnë shturjen e ardhshme të aktiviteteve të distribuimit dhe funizimit.

ZRRE mirëpret komente për të shtjelluar çështjen e LOMAG-ut në të ardhmen.

2.4 Gjendja e sistemit dhe përmirësimi i performancës

Në këtë shqyrtim dhe shqyrtimet e ardhshme, ZRRE-ja dëshiron të përqendrohet në shtytësit e përmirësimit të gjendjes së sektorit dhe të performancës. Duke kuptuar më mirë shtytësit e kostos së biznesit, ZRRE-ja beson se sektori mund t'i menaxhojë më mirë këto shpenzime. Për shembull, në anën e rrjetit, shtytësit e shpenzimeve do të përfshijnë ndërprerjet (numrin dhe kohëzgjatjen), nivelet e ulëta të tensionit dhe mbingarkesa e rrjetit. Të gjithë të licencuarve do t'u kërkohej të identifikojnë shtytësit e shpenzimeve të tyre në formate raportuese, dhe ti ndërlidhin programet për investim me përmirësimet e pritura në performancë

2.5 Humbjet

Të licencuarit e OST dhe OSSH mund të propozojnë investimet të cilat synojnë të adresojnë humbjet teknike, por ka më shumë gjasa të kombinohen me investime të tjera, posaçërisht masat për të lehtësuar mbingarkesën apo rëniet e tepërta të tensionit. Të licencuarit duhet të dëshmojnë dobësi për konsumatorin që dalin nga investimet në kuptim të përmbushjes së standardeve operative dhe të sigurisë si dhe humbjeve të zvogëluara teknike.

Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike do t'i kërkohej të mendojë mirë masat të cilat mund të zvogëlojnë humbjet komerciale gjatë periudhës përkatëse. Raporti i studimit të humbjeve i përgatitur në vitin 2011 nga AEAI ka identifikuar një numër të masave të mundshme.

2.6 Mekanizmat e stimulimit në kontrollin të hyrave

Rregullat e rishikuara të ZRRE-së lidhur me përcaktimin e çmimeve përmbajnë stimuj të nënkuptuar të ngërthyer në formulat algjebrike. Në veçanti, përcaktimi *ex ante* i të hyrave maksimale të lejuara lejueshme ofrojnë një nxitje të fortë për të reduktuar humbjet gjatë periudhës.

Stimuj më të qartë, me të cilat lidhen të ardhurat me performancën, përdoren nga rregullatorë të shumtë për të shpërblyer të licencuarit për rezultate të përmirësuar të sistemit në formë të disponueshmërisë më të madhe, besueshmërisë ose cilësisë më të mirë të furnizimit, për shembull.

ZRRE-ja ka aprovuar standardet të reja të performancës për të licencuarit që kanë hyrë në fuqi prej 1 Janarit 2011. Me vendosjen e këtyre standardeve, ZRRE ka fuqizuar edhe penalizimet në rastet kur i licencuari nuk arrin t'i përmbushë standardet e performancës. Deri më tani ZRRE është duke i monitoruar për së afërmi nëse kompanitë po i përmbushin këto standarde.

Comment [f15]: KEK-u ka ofruar këto të dhëna në dy shqyrtimet e fundit të tarifave. Çështja nuk është për "vendin" e referuar si LOMAG, por fakti që termocentralet dhe minierat duhet të ngarkohen për energjinë që ato marrin për funksionimin e tyre nga sistemi i transmissioinit dhe shpërndarjes .

Comment [f16]: Në një situatë normale, të licencuarit menaxhojnë dhe kontrollojnë kostot dhe rregullatorët miratojnë çmimet. Koncepti i Kontrollit të të Ardhurave tregon se fokusi është kryesisht në menaxhimin e ZRRE-së të çmimeve përfundimtare të shitjes me pakicë.

Comment [f17]: Sektori i energjisë në Kosovë vetëm sa ka filluar për të përcaktuar masat dhe për të raportuar mbi to. Do të kalojnë vite të tëra derisa "Gjobat" të jenë të përshtatshme. Gjithashtu, pasi që do të paguhet nga investitori i KEDS, ata do të mund të kenë nevojë të konsultohen në lidhje me këtë pasi KEK-u nuk është në dijeni të diskutimeve mes palëve.



ZRRE mirëpret mendimin e palëve të interesit nëse tani është e arsyeshme që të futen penalizimet e tilla (gjobat) për dështimet në arritjen e përmbushjes së këtyre standardeve nga kompanitë.

2.7 Kostoja e marrëveshjes

KOSTT-i aktualisht është duke rishqyrtuar marrëveshjet e tregut dhe i ka parashtruar ZRRE-së një Dizajn të detajuar të tregut i cili është në shqyrtim e sipër. Dizajni ngrit çështje të rëndësishme për sektorin, si për shembull çështjen e disa kostove të marrëveshjes në treg. Për të faturuar njëri tjetrin, palët duhet të dinë saktësisht se sa energji është dorëzuar dhe pranuar sipas marrëveshjeve të tyre bilaterale komerciale. Roli i marrëveshjeve është që të ofrojë këto të dhëna volumetrike. Mirëpo, shumica e konsumatorëve kosovarë nuk kanë orëmatës të cilët do të mundësonin regjistrimin e shpenzimit në intervale të caktuara. Zgjidhja mund të ishte të bëhet profilizimi i konsumit të konsumatorëve, apo të iniciohet një program për zëvendësimin e orëmatësve, duke ndërruar orëmatës të konsumit me orëmatës të intervalit. Asnjëra prej këtyre zgjidhjeve nuk është ideale. Shpenzimet për administrimin e orëmatësit, dhe si duhet të barten ato, gjithashtu duhet të merren parasysh.

ZRRE mirëpret qëndrimet e palëve të interesit lidhur me supozimet adekuate për qëllim të shqyrtimit tarifor.

2.8 Konkurrenca në treg

Neni 19 i Ligjit për Energjinë Elektrike iu jep të drejtë konsumatorëve shtëpiak që të zgjedhin furnizuesin e tyre që nga data 1 Janar 2015. Sipas një kriteri specifik të dalë nga konsultimi i rradhës gjatë muajit mars 2012, ZRRE ka konfirmuar se në mungesë të ndonjë furnizuesi të pavarur të licencuar për furnizim të konsumatorëve me pakicë, realisht nuk ekziston konkurrencë efektive sa i përket konsumit me pakicë në Kosovë. Megjithatë, furnizuesi publik FPEE duhet të bëjë disa supozime lidhur me parashikimin se kur do të ndryshojë kjo gjendje, dhe se si do të ndikojë kjo në kostot me pakicë.

ZRRE-ja mirëpret mendimin e të licencuarve në atë se çfare supozime duhet bërë sa i përket konkurrencës së ardhshme për qëllime të shqyrtimit TSHV.

2.9 Harmonizimi i kontrollit të të hyrave dhe viteve të kontabilitetit

Aktualisht të dyja kompanitë kanë kontabilitetin statutor për vite të ndara prej janarit deri në dhjetor. Viti kontabël rregullator historikisht ishte i ndryshëm nga prilli deri në mars. ZRRE-ja mendon se është kohë e duhur të konfirmojë nëse duhet vazhduar së ndjekuri praktika e deritanishme apo duhet bërë harmonizimi i viteve statusore dhe atyre rregullatore.

ZRRE mirëpret mendimin e palëve të interesit përkitazi me këto supozime.

Comment [f18]: KEK-u beson se për të bërë një gjë të tillë duhen shumë vite. Kosova do të jetë e kufizuar për të furnizuar të paktën deri në fund të kësaj dekade. Në komunikatat e mëparshme, ishte e qartë se disa vjet janë të nevojshme për zhvillimin e sistemeve standarde për Matjen e Performances dhe raportimit, para se çfare do gjobe të jete duke u vlerësuar për aplikim

Comment [f19]: ZRRE-ja ka bërë një vlerësim të konkurrencës në vitin 2011 dhe gjeti se nuk kishte të tilla. Kjo nuk do të ndryshojë për shumë vite.

Comment [f20]: Vitet kalendarike janë përdorur për të vendosur çmimet. Vonesa 3 mujore në datën efektive të ndryshimeve tarifore është për shkak të vonesave në fillimin e procesit tarifor.



2.10 Faktorët tjerë

Mund të ketë faktorë të tjerë të cilët duhet të shtellohen gjatë këtij shqyrtimi të TSHV. Këto mund të jenë parashikimet e prodhimit të ripërtërishtëm që janë në dispozicion të sistemit, dhe çmimi i tij; çështjet mjedisore; subvencionet për konsumatorët në nevojë; obligimet e shërbimit publik; rreshtimi me kërkesat ndërkombëtare të transmisionit sipas ENTSO-E dhe shpenzimet e respektimit të *acquis communautaire* (pakoja e 3-të).

ZRRE-ja mirëpret pikëpamjet e të licencuarve dhe palëve tjera të interesuara lidhur me faktorët tjerë që duhet të merren parasysh, si dhe supozimet që duhet të bëhen si pjesë e kësaj përpjekjeje.

3 Forma dhe struktura e kontrolleve të të hyrave

Kjo pjesë përvijëzon formën dhe strukturën e propozuar të kontrolleve të reja të të hyrave.

3.1 Kohëzgjatja e kontrolleve

Në pajtim me rregullat e reja të përcaktimit të çmimeve të shpallur nga ZRRE në vitin 2011, ZRRE do të përcaktojë kontrollet e të hyrave për 2013 si në vijim:

- 5 vite për aktivitetet e licencuara të OST dhe OSSH;
- 4 vite për aktivitetet e licencuara të prodhimit/mihjes (të shtyera nga 2012);
- 1 vit për aktivitetet e licencuara të Furnizuesit publik.

3.2 Natyra e kontrolleve

Kontrolli i ri do të jetë një kontroll shumë-vjeçar i të hyrave. Ai do të përcaktojë të hyrat maksimale të lejuara në euro që çdo i licencuar individual mund të fitojë gjatë periudhës së kontrollit për të mbuluar shpenzimet e tij operative dhe kapitale. Të licencuarit janë të lirë të udhëheqin bizneset e tyre brenda atyre kufizimeve të përgjithshme të të hyrave, gjë që inkurajon efikasitet më të lartë. Në fund të periudhës, dhe si pjesë e përcaktimit të kontrolleve të ardhshme shumë-vjeçare, ZRRE-ja do të synojë të konfirmojë nëse biznesi i ka përmbushur ose tejkaluar caqet e planifikuara të biznesit. Në rastet kur të licencuarit kanë mundur të sigurojnë cilësi të njëjtë ose më të madhe të shërbimit, për kosto më të ulët, konsumatorët do të përfitojnë nga kjo në periudhën e ardhshme të kontrollit, në formën e të hyrave më të ulëta për të licencuarit.

Pasi të hyrat maksimale të lejuara të jenë përcaktuar, do të varet nga të licencuarit që, sipas kushteve të legjislationit primar, të propozojnë tarifën dhe çmimet për shërbimet e tyre. Këto duhet të miratohen nga ZRRE-ja para se të hyjnë në fuqi në mars 2013.

Edhe pse iu mbetet të licencuarve të propozojnë tarifa (përfshirë strukturën e tyre), ZRRE-ja beson se do të ishte e arsyeshme që të licencuarve t'u ofrohen udhëzime, dhe në veçanti të licencuarit FPPE,

Comment [f21]: Për të siguruar pavarësinë, me mirë është që të mos ketë caqe të planifikuara biznesi nga rregullatori. Ato janë përgjegjësi e menaxhmentit. Rregullatorët vendosin objektiva të performancës, si pjesë e procesit tarifor, siç dëshmohet nga lejimet për humbjet teknike dhe komerciale të ndërtuar në tarifën për OSSH



mbi normën përcaktimit të çmimeve që pasqyrojnë më së miri shpenzimet. ZRRE-ja parasheh të kërkojë indikatorë të strukturave të mundshme të tarifave dhe çmimeve gjatë këtij viti, në mënyrë që propozimi formal i tarifave nga të licencuarit dhe miratimi i atyre tarifave të shkojë sa më lehtë.

3.3 Veçoritë stimuluuese të TSHV

Një prej përfitimeve kryesore të qasjes shumëvjeçare të përcaktimit të të ardhurave, është që mundëson stimuj më të fortë për të përmirësuar punën e operatorëve. Rregullat e reja të përcaktimit të çmimit ngërthejnë në vete një mekanizëm për të rritur efikasitetin e përgjithshëm të kompanive, krahas faktorëve specifik për të zvogëluar humbjet. Faktori i efikasitetit në veçanti duhet të ekuilibrohet kundrejt caqeve të qarta për cilësinë e shërbimit për të shmangur situatën ku të licencuarit ulin cilësinë e shërbimit të tyre, për shembull, duke shtyrë mirëmbajtjen e nevojshme.

Vendimi i ZRRE-së i 6 shkurtit tashmë ka përcaktuar faktorët e efikasitetit dhe të humbjeve për KEDS-in. Mirëpo, faktorët për KOSTT-in duhet të përcaktohen gjatë këtij shqyrtimi.

4 Vlerësimi i kostove në çdo biznes

Në këtë pjesë, ZRRE përshkruar në më shumë detaje natyrën e informatave mbi shpenzimet të cilat i kërkon nga të licencuarit si pjesë e këtij rishqyrtimi.

4.1 Natyra e shpenzimeve të çdo të licencuari

Si KOSTT-i ashtu edhe KEK-u kanë disa shpenzime siç janë kostot korporative të cilat nuk janë specifike për bizneset e rregulluara, por janë të centralizuara. Është me rëndësi që këto shpenzime të alokohen në mënyrë të duhur dhe të qartë për aktivitetet e ndryshme të licencuara, veçanërisht duke pasur parasysh shitjen e afërt të KEDS-it. ZRRE-ja do të kërkojë të kuptojë bazën e çfarëdo ndarjeje të bërë dhe të sigurohet se ajo është e arsyeshme.

Për bizneset me vlera të larta të aseteve siç janë minierat, transmisioni dhe shpërndarja, ZRRE-ja do të ndërmerr një shqyrtim të detajuar të shpenzimeve historike dhe veçanërisht atyre të parashikuara operative dhe të mirëmbajtjes.

4.2 Qasja e propozuar për vlerësimin e shpenzimeve

Në përputhje me praktikën e përgjithshme rregullative, ZRRE-ja pret nga të licencuarit që t'iu përgjigjen pyetjeve të definuara nga ZRRE-ja, dhe jo të varen nga pikëpamjet e vetë të licencuarve lidhur me informatat që i konsiderojnë të nevojshme për të mbështetur aplikacionet tarifore. Edhe pse KOSTT-i përgjithësisht ka përmbushur kërkesat e ZRRE-së në vitet e mëparshme, KEK-u deri tani nuk është përgjigjur në përputhje me kërkesat e ZRRE-së. Është me rëndësi thelbësore që të dy të licencuarit të përgjigjen në mënyrë konsistente dhe sistematike, duke përdorur formatet e raportimit, për t'u siguruar që ZRRE-ja të mund të kryejë rolin e tij statutor në mënyrë efektive. Edhe pse ZRRE-ja do të jetë përgjegjëse ndaj shqetësimeve të të licencuarve lidhur me të dhëna të veçanta që mund të

Formatted: Highlight

Comment [f22]: Meqë përmirësimet e efikasitetit mund të bëhen vetëm nga ana e kompanive / licencuarve, nuk është e qartë se si rregullat e çmimit mund të "Drejtojnë Efikasitetin".

Comment [f23]: Shpenzimet Korporative të KEK-ut që janë ndara për aktivitetet e të licencuara janë aktualisht 5% e kostos totale. Kur KEK-u dhe KEDS-i të jenë ndarë, personeli mbështetës do të transferohet në njërin ose tjetrën. Kjo do të thotë që kostot e mbështetjes do të jetë më afër në një linjë me aktivitetet e licencuara. Alokimi nuk ka qenë një çështje e madhe në të kaluarën dhe nuk pritet të jetë edhe në të ardhmen.



jenë vështirë të parashikohen, ajo është e bindur se informatat e kërkuara aktualisht nuk janë më shumë sesa që çdo operator kompetent do të duhej të kishte në dispozicion.

Struktura e shabllonëve janë të ngjashme për çdo divizion. Në përgjithësi, ato përqendrohen në

- Shpenzimet operative
- Shpenzimet kapitale
- Shtytësit e shpenzimeve

Formularët janë hartuar për të kapur të dhëna në mënyrë konsistente për pesë vite historike dhe pesë vite të parshikuara.

ZRRE-ja do të pret që çdo kompani të paraqesë komente tekstuale për të shpjeguar dhe mbështetur formularin e plotësuar të të licencuarit. Kjo në veçanti do të shpjegojë supozimet e përdorura. Kjo gjithashtu do të përshkruajë lidhjen midis shpenzimeve të pritura dhe kualitetit të përmirësuar si në kuptimin e obligimeve statusore ashtu edhe në kuptim të përmirësimit të shërbimit.

4.3 Faza 1 – Grumbullimi i të dhënave

ZRRE-ja ka lejuar dy muaj që kompanitë të plotësojnë shabllonët e raportimit, duke pasur parasysh se aktiviteti duhet të kryhet rreth sezonit të pushimit. ZRRE-ja vlerëson se me organizimin e duhur të brendshëm, kjo periudhë duhet të jetë e mjaftueshme për kompanitë.

Shabllonet e përfunduara, si dhe pjesa mbështetëse tekstuale, duhet të paraqesin aktivitetet e biznesit të kompanive gjatë pesë viteve të ardhshme. Në këmbim, ata do të kërkojnë të ardhura të mjaftueshme të cilat duhet të lejohen nga ZRRE-ja. ZRRE-ja beson se do të ishte veprim i qëlluar të kërkojë që secila nga kompanitë të bëjë një prezantim të parashitësive të tyre për ZRRE-në dhe për palët e tjera të interesuara në dëgjim publik. Kjo është planifikuar për të hënë më 3 shtator 2012.

Pas këtij prezantimi, ZRRE-ja do të fillojë analizën e aplikacioneve të kompanisë. ZRRE-ja parasheh se një numër i takimeve do të jetë i nevojshëm ndërmjet tyre dhe çdo kompanie për të sqaruar të dhënat dhe për t'u pajtuar mbi supozimet dhe ndikimin e tyre. Mund të ketë disa fusha ku kompanitë nuk janë në gjendje të ofrojnë të dhëna, por shpresohet se kjo do të minimizohet përmes kësaj përpjekjeje për konsultim.

4.4 Faza 2 – Analiza e të dhënave

Pas pranimit të aplikacioneve të të licencuarve, ZRRE do të analizojë të dhënat e dorëzuara duke shqyrtuar nivelin dhe ndarjen e shpenzimeve. Duke përdorur përvojën ndërkombëtare dhe rajonale, ZRRE do të kryejë kontrolle të konsistencës dhe besueshmërisë - identifikimin e zërave që mungojnë, numërimin e dyfishtë, etj.

Comment [f24]: Në vitin 2008, KEK-u takua me ZRRE-së për të propozuar një plan rregullator kontabel. Në atë kohë ZRRE-ja e bëri shumë të qartë se ata nuk shohin arsye për një plan kontabel. Në mënyrë që të sigurohen informatat të kontabilitetit në nivelin e detajuar në shumë nga format e të dhënave, është e dukshme që ZRRE-ja ka nevojë për të zhvilluar një Plan Rregullator Kontabel në qoftë se ajo ka nevojë për informacion në një nivel të caktuar detajesh. ZRRE-ja është e inkurajuar që së bashku të punojë me kontabilitetin e KEK-ut për të rishikuar skemën aktuale të llogarive të KEK-ut dhe të përdorin atë si një pikënisje. Disa nga informacionet që janë kërkuar mund të sigurohen nëse KEK-u e modifikon planin e saj kontabel duke filluar me vitin financiar 2013.

Comment [f25]: Formatet e raportimit kanë evoluar në vendet e zhvilluara gjatë dekadave. Ata përpunohen nga punonjës me përvojë shumëvjeçare dhe të mbështetura nga sistemet kompjuterike dhe kushtojnë dhjetëra miliona euro duke marrë shumë vite kohe për tu zhvilluar. Kosovës i duhen vite të tëra për të arritur atë nivel.

Comment [f26]: Plani i detajuar kontabel duhet të zhvillohet së pari, sepse ai nuk ekziston. Sistemet e Kontabilitetit dhe Raportimit nuk janë zhvilluar ende. Kosova është të paktën 2-3 vjet larg zbatimit të plotë të kësaj. Një fazë është e nevojshme në këtë qasje.

Comment [f27]: Menaxhmenti i ri i KEDS mund të ketë nevojë të jenë të përfshirë në këtë proces, nëse çmimi 5 vjeçar i tyre është duke u përcaktuar.



Kudo që të jetë e mundur, ZRRE-ja do të bëjë krahasime afariste duke përdorur kompanitë ndërkombëtare krahasuese, shpenzimet e zërave të capex-it, si dhe tregues kyç të performancës, për shembull kosto/MWh, kosto/konsumator, numrin e stafit/ MWh, numrin e stafit/konsumator. Këto krahasime afariste do të përdoren për të udhëhequr dhe mbështetur përcaktimin eventual të ZRRE-së lidhur me të ardhurat maksimale të lejuara.

Vështirësi shumë i afërt do t'i bëhet trendit të shpenzimeve historike ndërsa shpenzimet e parashikuara do të shqyrtohen nga ky kënd. Kompanitë duhet të shpjegojnë dhe të arsyetojnë çfarëdo ndryshimesh ndërmjet kostove. Është posaçërisht me rëndësi që kompanitë të shpjegojnë ndikimin e shpenzimeve të parashikuara në nivelin e parashikuar të performancës.

ZRRE-ja duhet të kërkojë të gjejë një ekuilibër ndërmjet çmimeve për konsumatorët dhe qëndrueshmërisë së biznesit. Prandaj, ajo do të shqyrtojë profitin apo humbjen eventuale të aktiviteteve të ndryshme të licencuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar që aktivitetet e licencuara të jenë individualisht të qëndrueshme dhe se shpenzimet të jenë shpërndarë në mënyrë të saktë dhe efektive në të gjithë sektorin.

Së fundi, ZRRE-ja do të vlerësojë ndikimin e kosove të të licencuarve në kërkesat e tyre për të ardhura të lejuara përmes modelit të kontrollit të të hyrave i cili do të rafinohet dhe të ndryshohet për t'ju përshtatur rregullave të reja të përcaktimit të çmimit. Në interes të transparencës, ky model do të ndahet me kompanitë për t'u siguruar që të gjitha palët të punojnë mbi një bazë të krahasueshme.

5 Përcaktimi i të hyrave

5.1 Modeli i kontrollimit të të hyrave

Modeli i kontrollit të të hyrave do të duhet të modifikohet për t'iu përshtatur logjikës së rregullave të reja për përcaktimin e çmimit. Ai do të marrë të dhënat nga të dhënat e kompanive dhe të parashikojë të ardhurat vjetore maksimale të lejuara. Modeli gjithashtu do të përmbajë edhe supozime lidhur me Bazën e rregulluar të aseteve (RAB), me koston e kapitalit, me humbjet, dhe me faktorët tjerë. Në rastin e OSSH dhe licencave të FPEE-së, disa prej këtyre faktorëve janë paracaktuar me vendim të ZRRE-së V_399_2012.

Rregullat mbi përcaktimin e çmimit parashohin një proces të rregullimeve vjetore. Ky proces është mjaft i ndryshëm nga shqyrtimet paraprake vjetore të tarifave. Këto janë rregullime "automatike" për të azhurnuar parashikimet e shpenzimeve të jashtme të pakontrollueshme - kostot e importeve, inflacioni etj. Modeli do t'i mundësojë ZRRE-së dhe kompanive që të vlerësojnë implikimet për çmimet dhe të ardhurat gjatë periudhës relevante të vitit kontrollues - dhe të ndihmojë në përcaktimin e shtegut të mundshëm të çmimeve i cili shmangë ndryshimet e menjëhershme të çmimeve duke zbutur të hyrat e lejuara gjatë TSHV-së.

Comment [f28]: Kryerja e analizave krahasimore të kësaj natyre mund të jetë e vështirë për tu përfunduar për të gjithë të interesuarit. Ndoshta një qëllim më real nevojitet që thjesht të bëjë një "Krahasim" të të dhënave në dispozicion.

Comment [f29]: Benchmarking kërkon identifikimin e aktiviteteve të ngjashme në kushte të krahasueshme.



5.2 Trajtimi i humbjeve

Nivelet e synuara për humbjet teknike dhe komerciale tashmë janë përcaktuar për OSSH-në dhe FPEE-në, por jo edhe për OST-në. ZRRE-ja synon të përcaktojë caqet e përshtatshme për humbjet në transmission duke marrë parasysh programin e kompanisë për investime. Duke vepruar kështu, ajo synon t'i lë një nxitje të konsiderueshme KOSTT-it që të tejkalojë cakun. Kjo do t'i lejojë KOSTT-it të mbajë për vete çfarëdo fitimi përtej caktuar gjatë periudhës së kontrollit. Këto fitime më të mëdha do t'iu kthehen konsumatorëve në fund të periudhës me një cak të ri.

Për të dyja kompanitë, ZRRE-ja dëshiron të kujdeset që humbjet aktuale për vitin 2012 (dhe në vitet e ardhshme) të raportohen mbi një bazë të krahasueshme me humbjet historike. Në rastin e KEK-ut, ka pasur tashmë një ekzaminim të detajuar të metodologjisë së raportimit të humbjeve në raportin e vitit 2011 të AEAI-së të përmendur më sipër.

Faktorët e humbjeve do të përfshihen në modelin e kontrollit të të hyrave. Stimulimet tjera gjithashtu mund të përfshihen në modelin e kontrollit të të hyrave. Këto mund të përfshijnë:

- Ngarkesën e sistemit – mënjanimin e mbingarkesës në qarqe [p.sh. uljen e caktuar në numrin e furnizuesve të mbingarkuar në fund të periudhës – kjo tashmë nënkuptohet në planin e distribucionit të KEK-ut ashtu që do të ishte e arsyeshme që të përcaktohej si një cak në TSHV.
- Lidhjet e reja – kohët e përgjigjeve për kërkesat për kyçje, numrin e kyçjeve të bëra
- Cilësia e furnizimit
 - Numri dhe kohëzgjatja e ndërprerjeve për konsumatorët, duke marrë parasysh caqet e përcaktuara me nenin 13 të licencës së OSSH-së.
 - Numrin e qarqeve me nivele të papranueshme të tensionit – sërisht, kjo tashmë është pranuar si një shtytës përbrenda planit të zhvillimit të distribucionit të KEK-ut.

Comment [f30]: Megjithatë, asnjë gjobe nuk është e përshtatshme

6 Hapat e ardhshëm

Palët e interesit ftohen të ofrojnë mendime lidhur me shabllonët e raportimit, dhe në veçanti:

- A është qëllimi i informacionit të kërkuar i arsyeshëm?
- A është mbulueshmëria e të dhënave complete?
- A janë kërkesat e të dhënave konsistente në të gjitha shabllonët?
- A ka ndryshime që do të siguronin një përputhje më të mirë me procedurat ekzistuese të raportimit në kompani?

Comment [f31]: Shiko komentet e KEK-ut in letren perçjellese

Comment [f32]: Shiko pergjigjet ne tabelen qe eshte ofruar

Comment [f33]: Po-shiko komentet ne letren qe eshte ofruar



- A ka sugjerime për të ndryshuar shabllonet e raportimit për të lehtësuar raportimin nga sistemet ekzistuese kontabiliste apo të menaxhimit të informatave?
- A ka të dhëna që aktualisht kompanitë nuk i kanë në dispozicion, dhe nëse po, si mund të tejkalohen zbrazëtitë e tilla?
- A është orari për përgjigje dhe reagime i arsyeshëm?

Comment [f34]: Po-KEK inkurajon ZRRE-ne te perdor te dhenat qe jane tani ne dispozicion. Me kohe sistemet e reja mund te zhvillohen nese jane me kosto te arsyeshme

Comment [f35]: Shiko pergjigjet qe jane ne tabelen e ofruar

Comment [f36]: JO-duke mare parasysh se investitori I ri i KEDS mund te kete nevoj te perfshihet ne kete konsultim.

6.1 Finalizimi i procesit të shqyrtimit të TSHV

ZRRE do të konfirmojë hapat dhe orarin përfundimtar të procesit të TSHV duke marrë për bazë reagime nga ky konsultim. ZRRE do të merr parasysh reagimet nga palët e interesuara dhe të ndryshojnë shabllonet e raportimit sipas nevojës. Në përputhje me letrën e [31 majit 2012], ZRRE parasheh të lëshojë shabllone përfundimtare për të licencuarit për t'i përfunduar deri më 9 korrik.



Shtojca – Formularët e raportimit